

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 817 Prot.

Tiranë, më 27.07 2016

VENDIM Nr. 89, datë 22.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10 të datës 22.07.2016, pasi shqyrtoi **Konceptin e sondazheve arkeologjike për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Parë KM 211.8 - KM 145"**, për zonat me potencial të lartë arkeologjik, kodra rreth fshatit Petovë, kodrat midis fshatrave Kutalli dhe Sqepur, kodrat nga fshati Ullinjas në fshatin Duhanas dhe pikërisht në pikat e mëposhtëme të këtyre zonave: Pika kilometrike 193+750 (midis APL 73 dhe APL 74); Pika kilometrike 192+250 (midis APL 79 dhe APL 80); Pika kilometrike 171+300 (APL 163); Pika kilometrike 170+500 (midis APL 166 dhe APL 167); Pika kilometrike 150+400 (APL 247); Pika kilometrike 150 (midis APL 248 dhe APL 249), subjekti "TAP AG", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. ,

VENDOSI:

1. Të miratojë **Konceptin e sondazheve arkeologjike për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Parë KM 211.8 - KM 145"**, për zonat me potencial të lartë arkeologjik, kodra rreth fshatit Petovë, kodrat midis fshatrave Kutalli dhe Sqepur, kodrat nga fshati Ullinjas në fshatin Duhanas dhe pikërisht në pikat e mëposhtëme të këtyre zonave:
 - Pika kilometrike 193+750 (midis APL 73 dhe APL 74)
 - Pika kilometrike 192+250 (midis APL 79 dhe APL 80)
 - Pika kilometrike 171+300 (APL 163)
 - Pika kilometrike 170+500 (midis APL 166 dhe APL 167)
 - Pika kilometrike 150+400 (APL 247)
 - Pika kilometrike 150 (midis APL 248 dhe APL 249)subjekti "TAP AG", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Investitori TAP AG për kryerjen e sondazheve arkeologjike sipas konceptit dhe metodologjisë të paraqitur nga shoqëria e licencuar në arkeologji, duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me këtë shoqëri dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.

3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO